



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60//01-27559/21
Kaçanik, 13.09.2021

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **X-të (Dhjetë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VI e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 13 Shtator 2021. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve të KK, me fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e KPF prej 7 anëtarëve sa ka KPF, pjesëmarrës në mbledhje morën 6 anëtarë: Kemal Mërseli, Nexhat Loku, Pranverë Loku-Zharku, Ekrem Kyçyku, Selim Reka dhe Rabije Sallahi. Në mbledhje mungoj me arsye anëtarja, Hafize Sallahi

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë; Nënkryetari i Komunës – Ylber Bajra, drejtorët e drejtorive: Bahri Selimi, Ukshin Qallaku, Ramadush Osmani, ndërkaq në pjesën e fundit të mbledhjes mori pjesë edhe, Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Nga zyrtarët e komunës në mbledhje ishte, Arbnora Kuka.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare për punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, znj. Hafize Sallahi me ka njoftuar së nuk mundet me marrë pjesë në mbledhje, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e X-të (Dhjetë) të Rregullt të KPF-a për vitin 2021, data 13 Shtator, me këtë;

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;
2. Propozim Vendim për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2022 dhe vlerësimet për vitet 2023-2024;
3. Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022;
4. Raporti i zbatimit të rekomandimeve të Auditorit për pasqyrat vjetore 2020;
5. Propozim Vendim për aprovimin e listës së veçantë të pronave komunale të cilat do të jepen në shfrytëzim në vitin 2022;
6. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore të Naim Krasniqi.

Kryesuesi i Kuvendit, Lidhur me rendin e punës e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 6 pikëve.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas rendit të punës;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF u aprovua njëzëri, me një plotësim që e potencoj Kryesuesi i Kuvendit, në faqen e fundit të konstatimi i vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në emër të Muhamet Malsiu, të shënohet numri i parcelës dhe numri i vendimit. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së IX-të (Nëntë) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë: 25.08.2021 /Lënda: 01Nr. 60//01-25469/21.

Procesverbali do të publikohet në faqen zyrtare të komunës i korrigjuar.

2. Propozim Vendim për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2022 dhe vlerësimet për vitet 2023-2024;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, mbledhja është thirrur pak me herët për shkak të zgjedhjeve lokale, në mënyrë që me miratuar me herët buxhetin. Vendim nuk kemi nga organet e nivelit qendror, por ne për me i zënë afatet kohore e kemi thirrur me herët këtë mbledhje, sepse nuk ka logjikë me mbajtë mbledhje pasi të filloj fushata zgjedhore. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë a jeni që t'i kaloj Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim, Propozim Vendim për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2022 dhe vlerësimet për vitet 2023-2024 ? Rezultati i votimit është njëzëri Për. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimin për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2022 dhe vlerësimet për vitet 2023-2024, dhe i njëjti i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

3. Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022;

Kryesuesi i Kuvendit, Edhe të kjo pikë në krahasim me buxhetin, përcaktohen normat tatimore të tatimit në pronë dhe taksat tjera. Drejtori i financave është këtu, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin; Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë Propozim Vendimin e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimin për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022; dhe i njëjti i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

4. Raporti i zbatimit të rekomandimeve të Auditorit për pasqyrat vjetore 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Të rekomandimet e raportit të auditorit për vitin 2020, shihet së 2 rekomandime janë zbatuar, 2 janë në proces të zbatimit dhe 2 ende nuk ka filluar zbatimin i tyre. Kishte me qenë mirë të fillohet edhe me zbatimin e atyre rekomandimeve të cilat nuk janë zbatuar ende.

z. Bahri Selimi- drejtor i DEFZH, Ne, për zbatimin e rekomandimeve të auditorit lidhur me pasqyrat financiare, raportojmë 1 herë në shtator dhe 1 herë në mars. Nga 6 të gjeturat si në Raportin e auditorit për vitin 2020, gati të gjitha rekomandimet janë zbatuar pjesërisht, që do të thotë se në përgjithësi janë në proces të zbatimit të tyre të gjitha rekomandimet e auditorit lidhur me pasqyrat financiare të PFV 2020.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që raporti t'j përcjellët Kuvendit të Komunës për shqyrtim? KPF njëzëri u pajtuan njëzëri për dërgimin e këtij raporti në procedurë të KK.

Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e shqyrtoj Raportin e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit për pasqyrat vjetore 2020 dhe të njëjtin ia përcjellë Kuvendit të Komunës në procedurë të shqyrtimit.

5. Propozim Vendim për aprovimin e listës së veçantë të pronave komunale të cilat do të jepen në shfrytëzim në vitin 2022;

Kryesuesi i Kuvendit, Kjo pikë ishte në rendin e punës edhe në mbledhjen e kaluar të KPF dhe KK dhe sinjerisht e themi se u refuzua pa asnjë arsytim të secilit subjekti politik që nuk e votuan. Secili refuzim i secilës pikë duhet të ketë arsyetimin për çka u refuzua. Ndoshta edhe ne nuk e arsyetuan sa duhet, për shkak që nuk pati diskutime, mund të jetë edhe kjo një prej arsyeve. Ne tani jemi në prag të zgjedhjeve lokale, ligji për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim tani e përcakton se pronat të cilat epën në shfrytëzim duhet të jenë të miratuara 1 vit me herët dhe të publikohen në faqen zyrtare, pastaj në vitin pasues varësisht prej rasteve të cilat paraqitën të shqyrtohen secila pronë e cila epët në shfrytëzim. Besoj se edhe anëtarët e KK e kanë keqkuptuar se këto prona nuk janë duke u dhënë në shfrytëzim tani. Kjo është një obligim ligjor që ne si komunë duhet me përmbushur, ndërkaq kushdo që vjen në pushtet ka me iu dashtë lista e miratuar për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale. Përsëri pronat të cilat epën në shfrytëzim dalin në KK, por pa qenë në listë nuk mund të procedohen në KK dhënia në shfrytëzim e tyre. Se cilat do të epen në shfrytëzim është varësisht nga kërkesat dhe varësisht nga vullneti i KK për përcaktimin e fituesve, por si listë mendoj se duhet të miratohet, se mund të paraqet hendikep për legjislaturën vijuese. Duhet pasur parasysh këtë fakt, se në mbledhjen e fundit të KK nuk u arsyetuar sa duhet dhe u refuzuar lista pa u dhënë arsytim. Për sqarime të nevojshme, fjalën e ka Kryetari i Komunës, Besim Ilazi.

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Unë nuk kam pritur të refuzohet kjo pikë në Kuvendin e Komunës, sepse nuk ka pasur arsye të mos miratohet. Ne e kemi pasur rastin për kompaninë :Golden Igel” që ishte e interesuar me marrë pronë komunale në shfrytëzim, por nuk kemi mundur me ia dhënë pronën komunale me të vetmen arsye, që prona komunale nuk ka qenë e publikuar në faqen zyrtare. Nuk d.m.th. këto prona të listuar të epën në shfrytëzim, nëse KK e sheh të arsyeshme që ndonjëra prej tyre të epet në shfrytëzim, atëherë e jep, nuk d.m.th që këto prona patjetër të epën në shfrytëzim në vitin 2022. Pa qenë lista e publikuar e pronave komunale, nuk epet asnjë pronë komunale në shfrytëzim, pavarësisht kërkesave serioze të investitorëve. Çështjet e dhënies në shfrytëzim të pronave komunale, shkojnë në KK edhe pas miratimit të listës.

z. Ukshin Qallaku- drejtor i DUKMM, Me miratimin e listës për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale, ne i hapim dyert komunës, nëse mendojmë që ndonjëherë prej këtyre pronave e japim në shfrytëzim në vitin 2022, në të kundërtën ia mbyllim dyert komunës për me dhënë prona komunale në shfrytëzim. Nëse na paraqiten kërkesa serioze të ndonjë ofertuesi, pse mos me i pasur dyert e hapura me vepruar, sepse pa qenë lista e publikuar, ne i kemi të mbyllur çështjen e dhënies së pronave komunale në shfrytëzim.

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka me diskutuar, e hapi diskutimin; Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë Propozim Vendimin e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimin për aprovimin e listës së veçantë të pronave komunale të cilat do të jepen në shfrytëzim në vitin 2022, dhe njëjti i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

6. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore të Naim Krasniqi;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, prona është e klasës së 5-të. Drejtori është këtu prezent për me dhënë sqarime të nevojshme. Nëse ka kush diçka në këtë pikë, e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Ne pajtohem që parcela e cila epët në shfrytëzim të konstatohet në procesverbal, ashtu siç e potencoj kryesuesi për konstatimin e një lëndë në procesverbalin e mbledhjes së kaluar, konstatimin në proces të ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore të miratuar në atë mbledhje.

z. Ukshin Qallaku- drejtori i DUKMM, Në bazë të konstatimit të dhënë në procesverbal të komisionit, gjendja faktike e pronës është bujqësore e klasës së 5, por kjo pronë e ka humbur karakterin bujqësor, për shkak të është e rrethuar me shtëpi të banimit. Pronës kërkohet me iu ndërruar destinimi vetëm 500m², d.m.th. jo krejt sipërfaqes së përgjithshme të parcelës kadastrale.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore të Naim Krasniqi; dhe i njëjti u miratua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF mori këtë:

VENDIM

Për miratimin e Propozim Vendimit të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit 06-350/01-25503/21 -Për Lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, të NAIM KRASNIQI nga Kaçaniku, në sipërfaqe 500m², në PK Nr. P-70917086-02168-9 në sipërfaqe të përgjithshme 2333m², ZK Kaçanik i Vjetër, në vendin e quajtur ÇARDAK, me kulturë bujqësore Livadh i klasës së 5 (Pestë), pronë private në emër të Naim (Hamza) Krasniqi, sipas Certifikatës me numër të lëndës: 25480/2021 të lëshuar nga Zyra Kadastrale me 20.08.2021 / Lënda: 01Nr. 06-350/01-25503/21.

Kryesuesi i Kuvendit, Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoj punimet në ora: 11:26. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë (6) anëtarët e KPF të cilët morën pjesë në këtë mbledhje.

Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 16 Shtator 2021 në ora 11:00.

Procesmbajtës

Makfire Malsiu

Makfire Malsiu

